



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 38 prot.

Kamëz, më 23. 4 .2026

V E N D I M  
Nr. 33 .Datë 23/4 2026  
M B I

**“MIRATIMIN E HARTËS SË PËRDITËSUAR TË KUFIJVE NDARËS  
ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE DHE FSHATRAVE BRENDA TERRITORIT TË  
BASHKISË KAMËZ.”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 23.04.2026, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.25 Datë 17.04.2026 në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr. 686, datë 22.11.2017 Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, Vendimit nr.360, datë 29.05.2019 “Për miratimin e hartës së përditësuar të kufijve administrativo-territorialë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, Vendimit nr. 20, datë 23.10. 2019 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për përcaktimin e mënyrës së zbatimit të planeve të përgjithshme vendore në fuqi, pas miratimit të hartës së përditësuar të kufijve administrativo-territorialë për njësitë e vetëqeverisjes vendore”, Vendimit nr. 1078, datë 23.12.2015 “Për miratimin e dokumentit “standartet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri, me tema - kufijtë e njësive administrative”; **Këshilli Bashkiak Kamëz”;**

V E N D O S I:

1. Miratimin e hartës së përditësuar të kufijve ndarës administrativo-territorial dhe kufijtë ndarës të fshatrave brenda territorit të Bashkisë Kamëz, si më poshtë vijon:
  - Njësia Administrative Kamëz, Qyteti Kamëz, Fshatrat; Bathore, Laknas, Valias, Frutikulturë, Bulçesh, Zall-Mner.
  - Njësia Administrative Paskuqan, Fshatrat; Paskuqan, Babrru Qëndër, Kodër e Kuqe, Shpat, Fushë e Kërçikëve, Kodër Babrru, Paskuqan Fushë, Paskuqan Kodër.
2. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYETAR KËSHILLI  
Hysen KOLDASHI

